		<b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b> <b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b> <b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b>	
Njësia:	<u>KO</u>	Nr. Prot.:	<u>46/2022</u>
Unit:		Prot. No.:	
Jedinite:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:	<u>-34-</u>	Data:	<u>17.12.2022</u>
No. of pages:		Date:	
Br. stranicat:		Datum:	
<small>Prishtinë</small>			



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

# KODI ZGJEDHOR

## I

# ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Dhjetor 2022, Prishtinë

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS** në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat e Vendimmarrjes së Organeve të OMK-së, miratuar në mbledhjen e datës 15 qershor 2021 të Kuvendit të OMK-së, e plotësuar dhe e ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 27 dhjetor 2022, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

## **KOD ZGJEDHOR TË ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 42/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 27 dhjetor 2022)

### **KREU I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kodi Zgjedhor i Odës së Mjekëve të Kosovës është akt normativ i cili ka për qëllim që të rregullojë dhe përcaktojë të drejtat zgjedhore, procedurat, kushtet, kriteret, autoritetin, kompetencat dhe përgjegjësitë në procesin e zgjedhjeve të brendshme përmes të cilave zgjidhen organet përfaqësuese të OMK-së në përputhje me dispozitat e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OMK-së dhe këtij Kodi.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Ky Kod zbatohet në të gjitha procedurat e zgjedhjes së organeve përfaqësuese të OMK-së, qofshin ato organe individuale apo kolegjiale.
2. Dispozitat e këtij Kodi nuk zbatohen për procedurat e zgjedhjes së organeve për të cilat procedurat e zgjedhjes janë të rregulluara me dispozita të veçanta të akteve të tjera normative të OMK-së.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Në kontekst të këtij Kodi, termet dhe akronimet e përdorura në te kanë këto kuptime dhe domethënie:
  - 1.1 **KQZ** - do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;

- 1.2 **Njësi Zgjedhore** - nënkupton bazën deleguese të përfaqësimit të anëtarëve në Kuvendin e OMK-së që themelohet në nivel të institucionit shëndetësor, apo shoqatës përfaqësuese të mjekëve;
- 1.3 **KNjZ (Komisionet e Njësive Zgjedhore)** - janë trupa organizative në varësi të KQZ-së që kujdesen për mbarrëvajtjen e procesit zgjedhor në njësinë përkatëse zgjedhore, që përfshinë institucionin shëndetësor përkatës.
- 1.4 **Lista e Votuesve** - nënkupton listën me të dhënat personale të profesionistëve shëndetësor me licencë valide, të cilët në bazë të dispozitave të këtij Kodi kanë statusin e anëtarit të OMK-së;
- 1.5 **Vëzhgues** - nënkupton personin e certifikuar nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin zgjedhor;
- 1.6 **Organizatë e akredituar** - organizatë joqeveritare e cila përmes procedurës së përcaktuar me këtë rregull zgjedhore akreditohet për ta vëzhguar procesin e zgjedhjeve pranë OMK-së;
- 1.7 **Libri i Votimit** - është formë e aprovuar nga KQZ-ja në të cilën shënohen vërejtjet përkitazi me procesin zgjedhor nga anëtarët e KNjZ-së, vëzhguesit dhe votuesit;
- 1.8 **OMK** - do të thotë Oda e Mjekëve të Kosovës.

## **KREU II - KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

### **Kapitulli I - Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 4**

#### **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe shpallë zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Odës dhe rezultatet e tyre.

#### **Neni 5**

#### **Selia e KQZ-së**

Selia e KQZ-së është e vendosur në Prishtinë.

#### **Neni 6**

#### **Vula e KQZ-së**

1. KQZ-ja ka vulën e vet autentike.

2. Përmbajtja, forma, dimensionet dhe mënyra e përdorimit të vulës përcaktohet me vendim të veçantë të KQZ-së.

## **Kapitulli II - Përbërja, kompetencat dhe përgjegjësitë organizative të KQZ-së**

### **Neni 7**

#### **Përbërja dhe mandati i KQZ-së**

1. KQZ-ja përbëhet prej pesë (5) anëtarëve që propozohen nga Këshilli Drejtues i OMK-së, ndërkaq zgjidhen nga Kuvendi i OMK-së.
2. Anëtarët e KQZ-së kanë mandat 5 (pesë) vjeçar nga dita e zgjedhjes së tyre dhe deri në përfundimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve me mandat të ri të KQZ-së. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së duhet të fillojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para skadimit të mandatit të anëtarëve aktual të KQZ-së.
3. Deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KQZ-së, anëtarët e mandatit aktual do të ushtrjnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KQZ-së.
4. Anëtarët e KQZ-së mund të zgjidhen vetëm për dy mandate me radhë të njëpasnjëshëm, dhe të njëjtit nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi të OMK-së.

### **Neni 8**

#### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e KQZ-së**

1. KQZ-ja në pajtim me këtë Kod ka këto përgjegjësi:
  - 1.1 Shpallë zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Odës;
  - 1.2 Përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve të anëtarëve të organeve të OMK-së;
  - 1.3. Zbatimin e veprimeve lidhur me procesin zgjedhor në përputhje me afatet e përcaktuara me rregullimin e brendshëm të OMK-së;
  - 1.4. Themelimin e njësive zgjedhore;
  - 1.5. Përgatitjen dhe miratimin e planit të veprimit dhe përcaktimin e detyrave të veçanta;
  - 1.6. Përcaktimin e afateve kohore për ekzekutimin e planit të veprimit dhe monitorimin e zbatimit të tij;
  - 1.7. Emërimin dhe certifikimin e anëtarëve të KNjZ-ve sipas kushteve të përcaktuara me rregullimin e brendshëm të OMK-së;
  - 1.8. Mbikëqyrjen e punës së KNjZ-ve dhe veprimeve përgatitore në procesin zgjedhor;
  - 1.9. Certifikimin e Listës së Votuesve në afatet e përcaktuara me Rregullën Zgjedhore të KQZ-së;
  - 1.10. Certifikimin e rezultatit zgjedhor dhe shqyrtimin e ankesave zgjedhore të parashtruara nga palët;
  - 1.11. Sigurimin e materialit zgjedhor për të gjitha KNjZ-të; dhe
  - 1.12. Kryen detyra të tjera të cilat i përcakton përmes akteve që i nxjerrë, me qëllim të menaxhimit të procesit zgjedhor.



2. Për çfarëdo nevoje të jashtëzakonshme, KQZ-ja do të shfrytëzojë aktet e brendshme juridike që janë të përcaktuara me këtë Kod me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

### **Neni 9**

#### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KQZ-së**

1. Anëtarët e KQZ-së kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 1.1. Kujdesen për zbatimin e këtij Kodi dhe akteve të tjera të nxjerra nga KQZ-ja;
  - 1.2. Marrin pjesë në mbledhjet e KQZ-së, dhe japin propozimet e tyre lidhur me çështjet që trajtohen në mbledhjet e KQZ-së;
  - 1.3. Kryejnë detyrat e besuara nga KQZ-ja, dhe ndërmarrin veprimet e përcaktuara sipas planit të miratuar të veprimit;
  - 1.4. Propozojnë plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës;
  - 1.5. Njoftojnë Kryesuesin dhe arsyetojnë për mos pjesëmarrje në mbledhje;
  - 1.6. Përmbahen dhe deklarohen në rast se dyshojnë lidhur me ekzistimin e ndonjë rrethane të konfliktit të interesit; dhe
  - 1.7. Kryejnë veprimet të tjera brenda fushëveprimit të KQZ-së.
2. Anëtari i KQZ-së është i obliguar që mungesën e tij në mbledhjen e ardhshme të thirrur të KQZ-së ta arsyetojë një mungesë të tillë. Në rast të tri mungesave të paarsyeshme, anëtari i KQZ-së do të humbet mandatin.

### **Neni 10**

#### **Kryesuesi i KQZ-së**

1. Kryesuesi i KQZ-së zgjidhet nga anëtarët e KQZ-së në pajtim me aktin e brendshëm të OMK-së për procedurat vendimmarrëse të organeve të OMK-së.
2. Kryesuesi i KQZ-së ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 2.1. Përfaqëson KQZ-në pranë institucioneve dhe publikut;
  - 2.2. Thërret mbledhjet e KQZ-së dhe propozon rendin e ditës;
  - 2.3. Kryeson mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
  - 2.4. Kujdeset për zbatimin e drejtë të këtij Kodi, vendimeve, akteve të tjera të KQZ-së dhe akteve normative të OMK-së brenda fushëveprimit të KQZ-së;
  - 2.5. Siguron transparencën e akteve ligjore dhe nënligjore të OMK-së, si dhe dokumenteve tjera që i nxjerr KQZ-ja;
  - 2.6. Nënshkruan vendimet dhe aktet të tjera të miratuara nga KQZ-ja; dhe
  - 2.7. Kryen dhe ndërmerr veprimet të tjera të nevojshme për funksionalitetin e KQZ-së.
3. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga paragrafi 2 i këtij neni, të njëjtat do të ushtrohen nga zëvendëskryesuesi i KQZ-së.

## **Neni 11**

### **Zëvendëskryesuesi i KQZ-së**

1. Zëvendëskryesuesi i KQZ-së zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KQZ-së me propozim të Kryesuesit të KQZ-së.
2. Zëvendëskryesuesi i KQZ-së zgjidhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KQZ-së.
3. Zëvendëskryesuesi i ushtron kompetencat e Kryesuesit në rast të mungesës së tij.
4. Në rast të mungesës së Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit, mbledhjet do t'i kryesojë anëtari në moshën më të vjetër në radhët e anëtarëve të KQZ-së.

## **Neni 12**

### **Mbledhjet e KQZ-së**

1. KQZ-ja mban mbledhjet e rregullta të paktën dy herë në javë nga shpallja e zgjedhjeve të OMK-së. Jashtë procesit të shpallur zgjedhor mbledhjet thirren sipas nevojës konkrete, në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të KQZ-së.
2. Mbledhjet e rregullta i thërret Kryesuesi me propozim të rendit të ditës për mbledhjen e thirrur.
3. Rendi i ditës dhe materiali përcjellës i dërgohet anëtarëve të KQZ-së, së bashku me ftesën për mbledhje.
4. Ftesa dhe materiali nga paragrafi 3 i këtij neni duhet t'u dërgohen anëtarëve të KQZ-së, së paku 24 orë para mbledhjes së thirrur.
5. Në pamundësi të thirrjes së mbledhjes nga Kryesuesi, mbledhja e rregullt mund të thirret edhe nga Zëvendëskryesuesi.
6. Mbledhjet e jashtëzakonshme të KQZ-së mund të thirren me kërkesën e të paktën 3 (tre) anëtarëve të KQZ-së. Detyrimet lidhur me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni nuk janë të zbatueshme me rastin e thirrjes së mbledhjes së jashtëzakonshme.
7. Për të gjitha mbledhjet e KQZ-së përpilohen procesverbalet të cilat po ashtu ruhen në arkivin e KQZ-së. Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur të KQZ-së miratohen në mbledhjen e radhës.
8. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë me dispozitat e veçanta të këtij Kodi lidhur me procedurat e vendimmarrjes, janë të zbatueshme dispozitat e Rregullores për Procedurat e Vendimmarrjes së Organeve të OMK-së.

## **Neni 13**

### **Procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së**

1. Procesverbali i mbledhjeve të KQZ-së përfshinë:

- 1.1 Datën dhe vendin e mbledhjes;
  - 1.2 Pjesëmarrësit që janë prezent në mbledhje;
  - 1.3 Rendin e ditës të aprovuar nga KQZ-ja;
  - 1.4 Çështjet e diskutuara në mbledhje;
  - 1.5 Vendimet që janë marrë; dhe
  - 1.6 Formën dhe rezultatin e votimeve.
2. Pas miratimit nga anëtarët e KQZ-së, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi.

#### **Neni 14**

#### **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. KQZ-ja ka kuorum kur janë të pranishëm të paktën tre (3) anëtarë të KQZ-së.
2. Para çdo vendimmarrjeje Kryesuesi i mbledhjes duhet të konstatojë kuorumin e mbledhjes.
3. Vendimet e KQZ-së merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KQZ-së, përjashtimisht kur është paraparë ndryshe me aktet e saj në fuqi.
4. Në rastet kur numri i votave për dhe kundër janë të barabarta, vota e Kryesuesit të mbledhjes është vendimtare.
5. Në çdo pikë të rendit të ditës, Kryesuesi e hapë diskutimin, e hedh në votim dhe konstaton përmbajtjen e vendimit dhe rezultatin e vendimit.
6. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari i KQZ-së ka për obligim që të vetëdeklarohet dhe të tërhiqet nga procedura e votimit. Në rast të mosdeklarimit të anëtarit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit, rrethana e tillë mund të denoncohet nga secili anëtarë i KQZ-së. Në rast të denoncimit të tillë Kryesuesi i mbledhjes e hedhë në votim denoncimin e arsyetuar. Në rast të vetë deklarimit apo denoncimit të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari që konsiderohet se gjendet në rrethana të tilla, përjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes për të cilën duhet vendosur.

#### **Neni 15**

#### **Votimi**

1. Votimi në mbledhjet e KQZ-së është i hapur.
2. Përjashtimisht votimi është i fshehtë në rast se ka të bëjë me zgjedhjen e individit për një funksion të caktuar.
3. Forma e votimit bëhet përmes votës PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM.
4. Vendimet e KQZ-së mund të merren edhe në procedurë qarkulluese. Procedura qarkulluese është procedurë e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja e KQZ-së.



5. Vendimet e KQZ-së merren me shumicën e thjeshtë të votave; përjashtimisht, kërkohet miratimi i 2/3 së anëtarëve të KQZ-së për çështjet si në vijim:

- 5.1 Miratimin e Rregullave Zgjedhore;
- 5.2 Certifikimin e Listës së Votuesve;
- 5.3 Certifikimin dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore; dhe
- 5.4 Vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e rezultateve.

#### **Neni 16**

#### **Aktet e KQZ-së dhe hyrja në fuqi e tyre**

1. KQZ-ja për qëllime të procesit zgjedhor nxjerr këto akte:
  - 1.1 Rregullat zgjedhore;
  - 1.2 Planin e Veprimit;
  - 1.3 Vendime;
  - 1.4 Udhëzime;
  - 1.5 Rekomandime ;
  - 1.6 Procesverbale dhe
  - 1.7 Akte të tjera.
2. Aktet e KQZ-së nga paragrafi 1 i këtij neni hyjnë në fuqi pas aprovimit nga KQZ-ja, nëse nuk parashihet ndryshe me aktin e miratuar.
3. KQZ-ja po ashtu miraton formën dhe dizajnin e fletëvotimeve për proceset zgjedhore të rregulluara me këtë Kod.

### **Kapitulli III - Sekretariati i KQZ-së**

#### **Neni 17**

Sekretariati i KQZ-së është njësi administrative e KQZ-së që në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësi, ndihmon KQZ-në në zbatimin e procesit zgjedhor në pajtim me këtë Kod dhe akte të tjera normative të OMK-së.

#### **Neni 18**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit të KQZ-së**

1. Për mbarëvajtjen e punëve administrative dhe logjistike kujdeset Sekretariati i KQZ-së.
2. Sekretariati i KQZ-së ushtron këto funksione:
  - 2.1. Bën njoftimin e anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të KQZ-së për mbledhjet e thirrura në pajtim me këtë Kod;
  - 2.2. Përgatit dhe dërgon materialin e nevojshëm sipas afateve të përcaktuara me këtë Kod dhe nga KQZ-ja;



- 2.3. Merr pjesë në ekzekutimin e planit të veprimit të miratuar nga KQZ-ja;
  - 2.4. Kryen të gjitha veprimet që i besohen nga KQZ-ja lidhur me procesin zgjedhor;
  - 2.5. Ofron mbështetje logjistike për nevojat e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor;
  - 2.6. Koordinon shpërndarjen dhe mbledhjen e materialit zgjedhor në afatet e përcaktuara me Planin e Veprimit;
  - 2.7. Pas shpalljes së zgjedhjeve dhe gjatë procesit zgjedhor, në raste kur është e nevojshme së bashku me anëtarët dhe zëvendësanëtarët viziton njësitë zgjedhore, për t'u siguruar se njësia zgjedhore përmbush kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve;
  - 2.8. Siguron mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve si dhe evidencën e pjesëmarrjes në mbledhje; dhe
  - 2.9. Kryen punë të tjera sipas nevojave të përkohshme.
3. Sekretariati i KQZ-së mund t'i propozojë KQZ-së çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet operationale të procesit zgjedhor, dhe të propozojë që çështjet të tilla të shqyrtohen në mbledhjen e KQZ-së.

#### **Neni 19**

#### **Përbërja e Sekretariatit të KQZ-së**

1. Sekretariatit të KQZ-së e përbëjnë zyrtarët e Shërbimit Profesional të OMK-së, të cilët varësisht nga përgatitja profesionale dhe detyrave të ndara, do t'i përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me këtë Kod.
2. Me kërkesë të KQZ-së, Këshilli Drejtues cakton përbërjen e Sekretariatit të KQZ-së, përfshirë koordinatorin e Sekretariatit, duke marr parasysh nevojat konkrete të KQZ-së.
3. Sekretariati i KQZ-së është bartës i detyrave dhe përgjegjësi që i vihen në përgjegjësi gjatë gjithë kohës sa zhvillohet procesi zgjedhor. Dispozitat e tilla do të jenë përshtatshëmrisht të zbatueshme edhe në rastet e zgjedhjeve të parakohshme, të jashtëzakonshme dhe ato të veçanta në ndonjë nga njësitë zgjedhore.

### **Kapitulli IV - Kandidimi dhe zgjedhjet për Kuvendin e OMK-së**

#### **Neni 20**

#### **E drejta për t'u zgjedhur**

1. Çdo anëtar i OMK-së gëzon të drejtën që të kandidojë dhe të zgjidhet anëtar i Kuvendit të OMK-së, i cili është i regjistruar dhe i licencuar si dhe është shtetas kosovar.
2. Kandidatin për anëtarë të Kuvendit të OMK mund ta propozojë cilido anëtar i OMK-së, i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të Odës brenda njësisë përkatëse zgjedhore.

#### **Neni 21**

#### **Përfaqësimi në Kuvendin e Odës**

1. Anëtarët e Kuvendit të OMK zgjidhen me votim të drejtpërdrejt në njësitë zgjedhore të përcaktuara nga komisioni qendror zgjedhor i OMK-së, sipas mënyrës dhe kritereve të përcaktuara me këtë Kod.
2. Përfaqësimi në Kuvendin e Odës konstituohet në kuadër të njësisë zgjedhore sipas çelësit përfaqësues si në vijim:
  - 2.1 Institucionet publike shëndetësore të nivelit parësor në çdo 50 anëtarë të regjistruar, zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së;
  - 2.2 Institucionet publike shëndetësore të nivelit dytësor në çdo 35 anëtarë të regjistruar, zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së;
  - 2.3 Institucionet publike të nivelit tretësor në çdo 25 anëtarë të regjistruar, zgjedhin një anëtar për Kuvendin e OMK-së.
3. Institucionet Private Shëndetësore (IPSH) do të përfaqësohen në Kuvendin e OMK-së varësisht nga statusi i IPSh-së. Çelësi i aplikuar për përfaqësimin e IPSh-ve që ofrojnë shërbime spitalore do të jetë i njëjtë me atë të nivelit dytësor dhe të njëjtat do të përfaqësohen sipas çelësit të paraparë për kujdesin dytësor, siç është përcaktuar me nënparagrafin 2.2 të këtij neni. Anëtarët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në shërbime jashtëspitalore në IPSH-të, do të përfaqësohen sipas çelësit të paraparë për kujdesin primar në pajtim me nënparagrafin 2.1 të këtij neni.
4. Anëtarët të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, do ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur në kuadër të njësisë zgjedhore të nivelit të kujdesit parësor në institucionin shëndetësor sipas vendbanimit të tyre.
5. Anëtarët e Odës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë institucioneve shëndetësore, do të përfaqësohen sipas mënyrës së paraparë me dispozitat e Statutit të OMK-së. Në këtë kategori përfshihen anëtarët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimit Korrektues dhe institucioneve të tjera gjegjëse.
6. Anëtarët që kanë statusin e specialistëve, të drejtat e tyre zgjedhore do t'i ushtrojnë në kuadër të njësisë zgjedhore për të cilat u është ndarë specializimi. Specialistët të cilët vijnë nga institucionet private shëndetësore i ushtrojnë të drejtat e tyre zgjedhore sipas mënyrës së paraparë për IPSH-të, respektivisht në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni. Specialistët të cilët ndjekin programin e specializimit me vetëfinancim, i ushtrojnë të drejtat zgjedhore në njësinë ku janë duke e kryer specializimin.

## Neni 22

### Kushtet për kandidim

1. Secila kandidaturë për anëtarë të Kuvendit të OMK duhet të mbështetet me nënshkrimin e të paktën 5 (pesë) anëtarëve të OMK, të njësisë përkatëse zgjedhore.
2. Paraqitja e kandidaturës bëhet brenda afatit prej 10 ditëve pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve.
3. Formulari me nënshkrime dorëzohet te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Neni 23**  
**Certifikimi i listës së kandidatëve**

1. Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ certifikon listën përfundimtare të kandidatëve sipas njësive zgjedhore dhe i publikon në afat prej 10 ditësh nga dita që ka përfunduar afati për dorëzimin e kandidaturave.
2. Nga dita e certifikimit të listës së kandidatëve, palët e pakënaqura lidhur me listën e certifikuar të kandidatëve për Kuvendin e OMK-së, mund të paraqesin ankesën e tyre në afat prej 24 orëve nga ora e publikimit. Ankesa parashtrohet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili shqyrton ankesën brenda 48 orëve nga ora që është pranuar ankesa.

**Neni 24**

1. Zgjedhjet për anëtarë të Kuvendit të OMK mbahen në njësitë zgjedhore.
2. Në kuadër të secilës njësi zgjedhore, e drejta e përfaqësimit të njësisë zgjedhore do të përcaktohet sipas çelësit të përcaktuar me nenin 21 të kësaj rregulloreje dhe çdo mandat përfaqësues i njësisë zgjedhore për kriter do ta ketë që çdo kandidat shtesë të ketë së paku gjysmën e numrit të çelësit sipas nivelit të kujdesit shëndetësor. Ky kriter aplikohet për çdo mandat pas mandatit të parë përfaqësues pasi që të jenë plotësuar kushtet për themelimin e njësisë zgjedhore sipas dispozitave të këtij Kodi.
2. Secili vendvotim ka numrin e vetë rendor të përcaktuar nga KQZ-ja.

**Kapitulli V - Procesi zgjedhor, mbarëvajtja dhe Plani i Veprimit**

**Neni 25**  
**Plani i Veprimit**

1. Plani i Veprimit është akt i miratuar i KQZ-së me të cilin bëhet konkretizimi i veprimeve dhe aktiviteteteve të KQZ-së dhe KNjZ-ve.
2. Plani i Veprimit do të përmbajë:
  - 2.1 Procesin e shpalljes së zgjedhjeve, njoftimin dhe publikimin si dhe, përcaktimin e metodologjisë së informimit;
  - 2.2 Koordinimin e veprimeve që do të ndërmerren nga anëtarët, zëvendësanëtarët dhe Sekretariati i KQZ-së;
  - 2.3 Veprimet që duhet ndërmarrë për sigurimin e Listës së Votuesve dhe veprimeve në lidhje me verifikimin e saj;



- 2.4 Oraret për sigurimin e materialit të nevojshëm për veprimet përgatitore të procesit zgjedhor;
  - 2.5 Caktimin e kohës dhe afateve për caktimin e anëtarëve të KNjZ-ve dhe procedimit për certifikim nga KQZ-ja;
  - 2.6 Mënyrën dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e materialit zgjedhor; dhe
  - 2.7 Të gjitha çështjet operacionale mbi përgatitjen, menaxhimin dhe përfundimin e procesit zgjedhor.
3. Plani i Veprimit i miratuar nga KQZ-ja mund të ndryshohet apo të plotësohet nga KQZ-ja sipas nevojave që paraqiten gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor.

### **Neni 26** **Shpallja e zgjedhjeve**

1. KQZ-ja me vendim të veçantë shpallë zgjedhjet tridhjetë (30) ditë para ditës së mbajtjes së tyre.
2. Mandati i Kuvendit të OMK-së mbaron në të njëjtin muaj të konstituimit të tij dhe mbajtja e zgjedhjeve duhet të bëhet në afat jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit, në pajtim me Rregulloren për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së. Afati për mbajtjen e zgjedhjeve është jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit, respektivisht ditës së fundit të muajit në të cilin përfundon mandati i Kuvendit.
3. Në vendimin e KQZ-së nga paragrafi 1 i këtij neni, KQZ-ja cakton datën e mbajtjes së procesit zgjedhor duke specifikuar orarin e hapjes dhe mbylljes së vendvotimeve në të cilat do të mbahet procesi zgjedhor.
4. Me rastin e vendosjes së shpalljes së zgjedhjeve, KQZ-ja do të lëshojë njoftimin publik me qëllim të njoftimit të të gjithë anëtarëve të OMK-së me të drejtë vote si dhe publikun e gjerë.
5. Për mënyrën e njoftimit KQZ-ja do ta udhëzojë Sekretariatit e KQZ-së lidhur me publikimin e shpalljes së zgjedhjeve.

### **Neni 27** **Zgjedhjet e jashtëzakonshme**

Zgjedhjet e jashtëzakonshme do të mbahen dhe organizohen nga KQZ-ja sipas afateve të njëjta sikurse zgjedhjet e rregullta, dhe në mënyrë të njëjtë do të jenë të zbatueshme dispozitat lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta që janë të parapara me këtë Kod, jo më larg se dyzetë ditë (40) ditë nga shpërndarja e kuvendit.

## **KREU II - KRIJIMI I LISTËS SË VOTUESVE**

### **Kapitulli VI - Lista e votuesve**



**Neni 28**  
**Përmbajtja e Listës së Votuesve**

1. Lista e Votuesve paraqet evidencë të anëtarëve të OMK-së me të drejtë vote e që përmban këto të dhëna:
  - 1.1 Njësinë Zgjedhore në të cilën e realizon të drejtën e votës anëtari;
  - 1.2 Emrin dhe mbiemrin e anëtarit;
  - 1.3 Datën e lindjes;
  - 1.4 Numrin e licencës;
  - 1.5 Numrin personal;
  - 1.6 Gjiminë; dhe
  - 1.7 Statusin profesional.
2. Lista e Votuesve nga paragrafi 1 i këtij neni sistemohet sipas Njësive Zgjedhore të OMK-së. Ndonëse Lista e Votuesve sipas këtij paragrafi sistemohet sipas Njësive Zgjedhore, ajo paraqet dokumentin unik të OMK-së i cili miratohet, përpunohet, mirëmbahet dhe përdoret nga KQZ-ja.
3. Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni do të përpunohen dhe menaxhohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 29**  
**Certifikimi i Listës së Votuesve**

1. Brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, Sekretariati i KQZ-së do të sigurojë listën e anëtarëve të OMK-së me të drejtë vote.
2. Lista e Votuesve do të përfshijë të gjithë anëtarët e OMK-së me të drejtë vote sipas kushteve lidhur me statusin e anëtarësisë në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Nenit 10, paragrafit 4 të Statutit të OMK-së.
3. Sekretariati i KQZ-së do të kujdeset që Lista e Votuesve të jetë kategorizuar sipas Njësive Zgjedhore.
4. KQZ-ja në afat prej tre (3) ditëve nga dita e pranimin të Listës së Votuesve të përgatitur nga Sekretariati i KQZ-së do të certifikojë Listën e Votuesve.

**Neni 30**  
**Evidentimi i anëtarëve në Listën e Votuesve**

1. KQZ-ja do t'i përfshijë anëtarët (mjekët e përgjithshëm, specialistët dhe specialistët) sipas Njësive Zgjedhore, që janë të angazhuar në sektorin publik:
  - 1.1 Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor;
  - 1.2 Institucionet e Kujdesit Dytësor Shëndetësor; dhe
  - 1.3 Institucionet e Kujdesit Tretësor Shëndetësor;

2. Mjekët që gjenden jashtë Republikës së Kosovës, ata të angazhuar në Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues, Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe ata në kuadër të institucioneve të mbrojtjes sociale, nuk do të jenë të përfshirë në Listën e Votuesve pasi që të njëjtit do të jenë të përfaqësuar sipas çelësit statutor të delegimit në Kuvendin e OMK-së.
3. Anëtarët e Odës të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, do të ushtrojnë të drejtat e tyre zgjedhore në kuadër të njësisë zgjedhore të Ministrisë së Shëndetësisë. Të njëjtit do të jenë të përfshirë në listën e votuesve.

### **Neni 31**

#### **Përpilimi, procedimi dhe certifikimi i Listës së Votuesve**

1. Lista e Votuesve përgatitet për procedim nga Sekretariati i KQZ-së duke marrë për bazë të dhënat zyrtare të institucioneve kompetente.
2. Sekretariati i KQZ-së nga themelimi i tij fillon përgatitjen e Listës së Votuesve duke përdorur burimet e cekura nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Sekretariati i KQZ-së do të kujdeset që ta përgatisë Listën e Votuesve sipas Nenit 5 të kësaj rregulle zgjedhore dhe për këtë do të përpilojë listën unike të sistemuar sipas Njësive Zgjedhore. Sekretariati i KQZ-së do ta përgatisë Listën preliminare të Votuesve jo më vonë se dhjetë (10) ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve nga KQZ-ja.
4. Pasi që ta ketë përgatitur Listën preliminare të Votuesve, Sekretariati i KQZ-së do t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim KQZ-së. KQZ-ja pas pranimit të Listës preliminare të Votuesve, atë do ta shpallë publikisht në ndonjë nga mjetet e komunikimit masiv.
5. KQZ-ja do ta certifikojë Listën e Votuesve në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas publikimit të Listës së Votuesve. Të gjithë personat të cilët nuk janë përfshirë në Listën e Votuesve dhe konsiderojnë se me këtë u është cenuar e drejta e votës, kanë të drejtë që të paraqesin ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orëve nga publikimi i Listës preliminare të Votuesve. KQZ-ja do të vendos për një ankesë të tillë në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga ora e pranimit të ankesës.
6. Me aprovimin e ankesës, KQZ-ja sipas detyrës zyrtare e ndryshon Listën e Votuesve në përputhje me dispozitivin e vendimit me të cilin ka vendosur në mënyrë meritore për ankesën e parashtruar.
7. Parashtrimi i ankesës dhe çfarëdo vendimi i cili merret nga KQZ-ja nuk e pezullon procedurën e certifikimit të Listës së Votuesve.

### **Neni 32**

#### **Distribuími dhe përdorimi i Listës së Votuesve**

1. Pas certifikimit të Listës së Votuesve, KQZ-ja do të sigurojë për secilën KNjZ Listën e Votuesve për Njësinë përkatëse Zgjedhore. KNjZ-të do të disponojnë vetëm pjesën e Listës së Votuesve në të cilën përfshihen anëtarët me të drejtën e votës në njësinë përkatëse zgjedhore.
2. Listat e Votuesve për secilën Njësi Zgjedhore do t'i distribuohen KNjZ-ve përmes Sekretariatit të KQZ-së. Sekretariati i KQZ-së është i obliguar që Listat e Votuesve për Njësitë Zgjedhore t'ua dërgojë në afat jo më të largët sesa njëzet e katër (24) orë para hapjes së vendvotimit.
3. Nga momenti i dorëzimit të Listës së Votuesve për Njësinë Zgjedhore përkatëse, përgjegjësia për ruajtjen e saj është e kryesuesit të KNjZ-së.
4. Lista e Votuesve për çdo KNjZ do të përmbajë të dhënat si në vijim:
  - 4.1 Emrin dhe mbiemrin e anëtarit;
  - 4.2 Datën e lindjes;
  - 4.3 Numrin e licencës;
  - 4.4 Numrin personal;
  - 4.5 Gjininë;
  - 4.6 Statusin profesional; dhe
  - 4.7 Hapësirën për nënshkrim të votuesit.
5. Lista e përgjithshme e votuesve do të jetë në përkujdesje të KQZ-së, dhe e njëjta paraqet dokumentin që përfshinë tërësinë e të dhënave të anëtarëve të OMK-së me të drejtë vote.

## **KREU III - PËR KRIJIMIN E NJËSIVE ZGJEDHORE DHE KOMISIONET E NJËSIVE ZGJEDHORE**

### **Kapitulli VII - Njësitë Zgjedhore**

#### **Neni 33**

#### **Themelimi i Njësie Zgjedhore**

1. KQZ-ja ka kompetencë ekskluzive që të themelojë Njësitë Zgjedhore duke respektuar çelësin përfaqësues të sanksionuar me këtë Kod, varësisht nga niveli i përfaqësimit institucional.
2. Njësia Zgjedhore themelohet pranë çdo institucioni shëndetësor në të cilin janë të punësuar të paktën njëzet (20) anëtarë të OMK-së, pa marrë parasysh statusin e tyre specialistik dhe nivelin e kujdesit shëndetësor të cilin e ofron institucioni përkatës.
3. Institucionet shëndetësore në të cilat ka më pak se njëzet (20) anëtarë, do t'i bashkëngjiten Njësisë më të afërt Zgjedhore. Në çdo rast kur një Njësie Zgjedhore i bashkohen anëtarët nga një institucion tjetër i cili nuk mund të përmbush kushtin e themelimit të Njësisë Zgjedhore sipas paragrafit 2 të këtij neni, e drejta e delegimit të anëtarëve në Kuvendin e OMK-së sipas numrit të anëtarëve do të llogaritet në tërësi duke përfshirë edhe anëtarët e institucionit shëndetësor i cili është fuzionuar në Njësinë Zgjedhore.



4. Për bashkëngjitjen e institucionit shëndetësor sipas paragrafit 3 të këtij neni kriteret bazë do të jenë:
  - 4.1 Njësia Zgjedhore e cila gjendet në të njëjtën njësi administrative (komunë); dhe
  - 4.2 Afërsia gjeografike me Njësinë Zgjedhore.
5. Për themelimin e Njësive Zgjedhore, KQZ-ja do të nxjerrë vendim në të cilin do të shënojë domosdoshmërisht:
  - 4.1 Njësinë Zgjedhore në emërtim të institucionit dhe komunës në të cilën gjendet njësia;
  - 4.2 Numrin e anëtarëve nga të cilët përbëhet Njësia Zgjedhore; dhe
  - 4.3 Numrin e delegimit të anëtarëve për Kuvendin e OMK-së;
6. Me nxjerrjen e vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni konsiderohet se Njësitë Zgjedhore janë të themeluara.

### **Neni 34** **Njësitë e veçanta zgjedhore**

1. KQZ-ja me qëllim që të sigurojë përfaqësimin e të gjithë anëtarëve të OMK-së dhe të drejtën e votës, mund të themelojë njësitë e veçanta zgjedhore në të cilat do të përfshihen anëtarët të cilët nuk janë të angazhuar në institucionet shëndetësore.
2. Njësitë e tilla zgjedhore grupohen në njësi të vetme dhe mund të përfshijnë anëtarët të cilët nuk janë në marrëdhënie pune në ndonjë nga institucionet shëndetësore apo të cilët janë të angazhuar në aktivitetin akademik.
3. Njësia e veçantë zgjedhore do të themelohet sipas kriterit nga paragrafi 2 i Nenit 4 të kësaj rregulle zgjedhore.

## **Kapitulli VIII - Komisionet e Njësive Zgjedhore**

### **Neni 35** **Themelimi i Komisioneve të Njësive Zgjedhore**

1. Në çdo Njësi Zgjedhore themelohet Komisioni i Njësisë Zgjedhore.
2. KNjZ-të kanë kompetencë dhe përgjegjësi për:
  - 2.1 Mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimin e Njësisë Zgjedhore;
  - 2.2 Zbatimin e të gjitha masave të përcaktuara nga KQZ-ja për ta menaxhuar procesin e votimit;
  - 2.3 Kujdesin ndaj materialit zgjedhor dhe përdorimin e tij sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja;
  - 2.4 Shmangien dhe raportimin e parregullsive zgjedhore në rast të evidentimit të tyre; dhe
  - 2.5 Kryerjen e punëve të tjera të besuara nga KQZ-ja;
3. KNjZ-të do të kenë mandat deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja.



**Neni 36**  
**Përbërja e KNjZ-ve**

1. KNjZ-të përbëhen nga tre (3) anëtarë të cilët propozohen nga Njësia Zgjedhore dhe certifikohen nga KQZ-ja.
2. KNjZ-të kanë një kryesues dhe dy komisioner të cilët i ndajnë detyrat në mes vete në pajtim me rregullën e veçantë të KQZ-së dhe sipas menaxhimit të besuar të kryesuesit të KNjZ-së.
3. KNjZ-të certifikohen me vendim të KQZ-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.
4. KQZ-ja në vendimin e saj për certifikimin e anëtarëve të KNjZ-ve do të saktësojë përbërjen e tyre në kuadër të secilës Njësie Zgjedhore.

**Neni 37**  
**Autorizimet e anëtarëve të KNjZ-ve**

Anëtarët e KNjZ-ve do të kenë kompetenca dhe autorizime që do të përcaktohen me dispozita të veçanta për votimin në vendvotime që janë të përfshira në këtë Kod. Për nevoja të veçanta KQZ-ja mund të nxjerrë akt të veçantë me të cilin mund të përcaktojë kompetenca dhe përgjegjësi shtesë.

**KAPITULLI IV - VËZHGIMI I PROCESIT ZGJEDHOR**  
**Kapitulli IX - Procedimi i kërkesave për vëzhgim**

**Neni 38**  
**Propozimi i vëzhguesve**

1. Secili kandidat i cili merr pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë që të propozojë një (1) person në cilësi të vëzhguesit në Njësinë Zgjedhore në të cilën i është certifikuar kandidatura.
2. Kandidati mund ta propozojë vëzhguesin vetëm brenda Njësisë Zgjedhore në të cilën zgjidhet nga anëtarët e Njësisë Zgjedhore.
3. Për të propozuar vëzhguesin kandidati duhet që të parashtrijë kërkesën pranë KNjZ-së së bashku me formularin për kandidim dhe jo më se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
4. Formulari i kërkesës nga paragrafi 3 i këtij neni është i bashkëngjitur në Shtojcën I të kësaj rregulle zgjedhore.

**Neni 39**  
**Kërkesat e organizatave për akreditim**

1. Organizatat joqeveritare që shprehin interes për të përcjellë procesin zgjedhor në OMK, kanë të drejtë që të parashtrijë kërkesën për akreditim nga dita kur zgjedhjet për Kuvendin e OMK-së të jenë shpallur nga KQZ-ja.

2. Kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni duhen parashtruar pranë KQZ-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Organizatat joqeveritare që e parashtrojnë kërkesën për akreditim kanë të drejtë që të propozojnë nga një përfaqësues në cilësi të vëzhguesit për një vendvotim.
4. Formulari i kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni është i bashkëngjitur në Shtojcën II të kësaj rregulle zgjedhore.

#### **Neni 40**

##### **Akreditimi i vëzhguesve dhe organizatave**

1. KQZ-ja do të akreditojë organizatat joqeveritare dhe vëzhguesit e kandidatëve jo më vonë se dhjetë (10) ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Me rastin e akreditimit të vëzhguesit dhe organizatave joqeveritare, KQZ-ja do ta nxjerrë listën e vëzhguesve dhe organizatave të akredituara për secilin vendvotim. Lista e tillë do t'i dërgohet KNjZ-ve.
3. Në listën nga paragrafi 2 i këtij neni KQZ-ja do të shënojë të dhënat e secilit përfaqësues të një organizate që ka parashtruar kërkesën për akreditim, duke specifikuar vendvotimin për të cilin është akredituar përfaqësuesi i organizatës së akredituar.
4. Në qoftë se kërkesat e kandidatëve apo të organizatave joqeveritare, nuk përmbushin kushtet që janë të cekura në formularët e kërkesave të bashkëngjitura me Shtojcat I dhe II të kësaj rregulle zgjedhore, si dhe kushtet të tjera që janë të përfshira me dispozitat e kësaj rregulle zgjedhore, KQZ-ja do të refuzojë akreditimin e tyre.
5. Palët e interesuara kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë KQZ-së, në një afat prej dyzetë e tetë (48) orëve nga ora e publikimit të listës së subjekteve të akredituara dhe atyre që u janë refuzuar kërkesat për akreditim.
6. Për ankesat nga paragrafi 5 i këtij Neni, KQZ-ja do të vendos në një afat prej dyzetetetë (48) orëve nga përfundimi i afatit për parashtrim të ankesave. Ndaj vendimit të KQZ-së nuk lejohet parashtrimi i ankesës, kurse pala e pakënaqur me vendimin e KQZ-së mund të parashtojë padi pranë gjykatës kompetente në procedurën e konfliktit administrativ.

#### **Kapitulli X - Autorizimet e vëzhguesve**

##### **Neni 41**

##### **Të drejtat e vëzhguesve të akredituar**

1. Vëzhguesit e akredituar, duke përfshirë vëzhguesit e propozuar nga kandidatët apo përfaqësuesit e organizatave të akredituara, nga ora kur hapet vendvotimi e deri në përfundimin e numërimit të votave pranë KNjZ-ve kanë këto të drejta:
  - 1.1 të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës nga hapja dhe mbyllja e vendvotimit e deri në përfundimin e numërimit të votave në KNjZ;
  - 1.2 të vëzhgojnë çdo veprim të komisionerëve dhe të vrojtojnë mënyrën e punës në vendvotim;
  - 1.3 të vëzhgojnë mënyrën e identifikimit të votuesve nga Lista e Votuesve;
  - 1.4 të mbajnë shënime lidhur me ecurinë e procesit në vendvotim;
  - 1.5 të jenë të pranishëm me rastin e plotësimit të procesverbalit të vendvotimit; dhe
  - 1.4 të paraqesin vërejtjet e tyre në Librin e Votuesve;
2. Në rast se vëzhguesi i kandidatit nuk ka shënuar vërejtjen e tij në Librin e Votuesve, kandidati në ankesën e tij nuk mund ta bazojë pretendimin në dëshminë e vëzhguesit i cili ka qenë i akredituar sipas propozimit të tij.

#### **Neni 42**

#### **Ndalesat dhe përmbajtja e vëzhguesve**

1. Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e akredituar gjatë procesit zgjedhor nuk kanë të drejtë të realizojnë çfarëdo komunikimi me votuesit.
2. Vëzhguesit nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim përmes të cilit do të ndikonin në vullnetin e lirë të votuesve.
3. Në çdo rast kur cilido komisioner vëren që vëzhguesi nuk i përmbahet rregullave të vendvotimit, vërejtjen e tillë do ta shënojë në Librin e Votuesve dhe për këtë do ta njoftojë kryesuesin e vendvotimit. Kryesuesi i vendvotimit duhet t'ia tërheq vërejtjen vëzhguesit për sjelljet e tilla dhe në rast të përsëritjes ai duhet të kërkojë largimin e vëzhguesit nga vendvotimi.

#### **Neni 43**

#### **Ankesat nga vëzhguesit dhe organizatat e akredituara**

1. Vëzhguesit dhe organizatat e akredituara kanë të drejtë që të parashtrojnë ankesë lidhur me parregullsitë që i evidentojnë në vendvotimin e KNjZ-së pranë të cilës janë akredituar.
2. Ankesa nga paragrafi 1 i këtij neni i parashtrohet KQZ-së në një afat prej njëzet e katër (24) orëve nga mbyllja e vendvotimit. KQZ-ja duhet të vendos për ankesën e parashtruar në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga ora e parashtrimit të ankesës.

### **KREU V - KOMISIONET E NJËSIVE ZGJEDHORE**



## **Kapitulli XI - Kompetencat dhe përbërja e KNjZ-ve**

### **Neni 44**

#### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e KNjZ-ve**

4. KNjZ-të janë organe të përkohshme të OMK-së që themelohen në kuadër të Njesisë përkatëse Zgjedhore si pjesë organizative e KQZ-së së OMK-së, dhe që funksionojnë për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për Kuvendin e OMK-së.
5. KNjZ-të kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 7.1 të pranojnë dhe dorëzojnë pranë KQZ-së formularët për kandidimin për anëtar të Kuvendit të OMK-së;
  - 7.2 të pranojnë dhe dorëzojnë pranë KQZ-së formularët për certifikimin e vëzhguesve dhe akreditimin e organizatave që shprehin vullnetin për monitorimin e zgjedhjeve të shpallura;
  - 7.3 të pranojnë dhe dorëzojnë materialin e dorëzuar zgjedhor sipas përbërjes së përcaktuar me rregull të veçantë zgjedhore;
  - 7.4 mbarëvajtjen e procesit zgjedhor që nga veprimet përgatitore para hapjes së vendvotimit, mbajtjes së procesit zgjedhor, numërimit dhe dorëzimit të materialit zgjedhor në KQZ; dhe
  - 7.5 punë të tjera që mund të përcaktohen nga rregullat e KQZ-së.
6. KNjZ-të kanë mandat për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga paragrafi 2 i këtij neni deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja.

### **Neni 45**

#### **Përbërja e KNjZ-ve**

1. KNjZ-të përbëhen prej tre (3) komisionerëve që propozohen nga Njësia Zgjedhore.
2. Komisionerët e certifikuar do të kenë funksione si në vijim:
  - 2.1 Kryesuesin e KNjZ-së;
  - 2.2 Komisioneri për Listë të Votuesve; dhe
  - 2.3 Komisioneri kontrollor.
3. Përzgjedhja e kryesuesit të KNjZ-së bëhet me marrëveshje në mes të komisionerëve të KNjZ-së.
4. Detyrat dhe funksionet konkrete të komisionerëve sipas funksionit të përcaktuar me dispozitën e paragrafit 2 të këtij neni do të përcaktohen më konkretisht në rregullën e veçantë për procesin e votimit.

## **Kapitulli XII - Certifikimi i komisionerëve**



## **Neni 46**

### **Certifikimi i komisionerëve të KNjZ-së**

1. Komisionerët e propozuar sipas paragrafit 44 të këtij Kodi, certifikohen nga KQZ-ja.
2. Sekretariati i KQZ-së do ta dorëzojë listën e komisionerëve të propozuar për secilën Njësi Zgjedhore në një afat prej tre (3) ditëve para afatit për certifikimin e komisionerëve.
3. KQZ-ja certifikon komisionerët e propozuar në një afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve për Kuvendin e OMK-së.
4. Palët e pakënaqura me vendimin për certifikim të komisionerëve mund të parashtrojnë ankesën e tyre pranë KQZ-së në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga përfundimi i ditës në të cilën është nxjerrë vendimi për certifikim. Ankesa e parashtruar kundër vendimit për certifikim nuk do ta pezullojë vendimin e ankimuar.

## **Neni 47**

### **Papërshtatshmëria për certifikim të komisionerëve**

1. Komisioneri i propozuar nuk mund të jetë kandidat për zgjedhjet për Kuvendin e OMK-së. Në rast të parashtrimit të formularit për kandidim, kërkesa e tillë nuk do të certifikohet nga KQZ-ja.
2. Komisioneri i propozuar nga Njësia Zgjedhore duhet të jetë i punësuar pranë njësisë zgjedhore për të cilën është propozuar. I njëjti nuk mund të jetë i deleguar nga ndonjëra bazë deleguese sipas çelësave statutore të parapara për përfaqësim në Kuvendin e OMK-së.
3. Komisioneri gjithashtu nuk do të mund të certifikohet në rast se i njëjti ka dhënë pëlqimin për kandidim për ndonjë nga kandidatët të cilët kanë parashtruar formularin për kandidim për anëtar të Kuvendit të OMK-së.
4. Secila nga arsyet e përkufizuara nga dispozitat e këtij neni do të jenë bazë e mjaftueshme për decertifikim të komisionerit.
5. Pa marrë parasysh afatet e parapara me këtë Kod, KQZ-ja në çdo kohë kur do ta kuptojë për ekzistimin e pengesave juridike të sanksionuara me këtë Kod mund ta decertifikojë komisionerin e certifikuar.
6. Në rast të decertifikimit komisioneri i decertifikuar do të zëvendësohet në mënyrë të njëjtë sipas propozimit të Njësive Zgjedhore.

## **KREU VI - MENAXHIMI I VENDVOTIMEVE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR**

### **Kapitulli XIII - Veprimet përgatitore në vendvotime**

## **Neni 48**

### **Vendvotimet dhe vendosja e tyre**

1. Vendvotimet në të cilat mbahet procesi zgjedhor do të vendosen nëpër Njësitë Zgjedhore të themeluara me vendim të veçantë të KQZ-së.
2. KNJZ-të kanë për obligim që në koordinim me menaxhmentin e institucionit shëndetësor të përcaktojnë lokacionin e vendvotimit brenda hapësirës së institucionit gjegjës shëndetësor që sipas vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet si Njësi Zgjedhore.
3. Për lokacionin e përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, KQZ-ja do të njoftohet nga KNJZ-të paktën shtatëdhjetë e dy (72) orë para fillimit të procesit zgjedhor.
4. Në rast të ndonjë ndryshimi për shkaqe objektive, KNJZ-të mund ta ndërrojnë lokacionin e vendvotimit të përcaktuar paraprakisht. Për ndryshimin e tillë KNJZ-të duhet ta njoftojnë KQZ-në në kohë sa më të shpejtë para fillimit të procesit zgjedhor.

## **Neni 49**

### **Dorëzimi dhe pranimi i materialit zgjedhor**

1. Kryesuesi i KNJZ-së është zyrtari i autorizuar që të bëjë pranimin dhe dorëzimin e materialit zgjedhor nga dhe tek KQZ-ja.
2. Me rastin e pranimit të materialit zgjedhor, kryesuesi i KNJZ-së do të nënshkruaj një procesverbal të veçantë që është miratuar nga KQZ-ja dhe i cili mban evidencën me të dhënat siç janë:
  - 2.1 Listën e Votuesve të Njësisë përkatëse Zgjedhore;
  - 2.2 Numrin e përcaktuar të fletëvotimeve për Njësinë Zgjedhore;
  - 2.3 Librin e Votimit;
  - 2.4 Kopjen e procesverbalit mbi pranimin e materialit zgjedhor;
  - 2.5 Procesverbalet e vendvotimit dhe të KNJZ-së mbi procesin zgjedhor;
  - 2.6 Kutinë për votim me numrin e bashkëngjitur të vendvotimit; dhe
  - 2.7 Thesin për ambalazhimin e materialit zgjedhor.
3. Kryesuesi i KNJZ-së duhet ta merr një kopje të procesverbalit nga paragrafi 2 i këtij neni mbi pranimin e materialit zgjedhor nga KQZ-ja. Kopja e procesverbalit do të ri-nënshkruhet nga kryesuesi i KNJZ-së dhe personi i autorizuar nga Sekretariati i KQZ-së.

## **Neni 50**

### **Përgatitja e vendvotimit**

1. Komisionerët e KNJZ-ve janë përgjegjës për përgatitjen teknike të vendvotimeve nëpër Njësitë Zgjedhore.
2. Komisionerët do të rregullojnë në atë mënyrë vendvotimin, ashtu që do të rendisin tavolinën në ballë të hyrjes së vendvotimit ku do të qëndrojë komisioneri për Listë të Votuesve, ndërkaq kutia e votimit do të vendoset në mesin e hapësirës së vendvotimit.



3. Komisionerët janë të obliguar që të përgatisin vendin e veçantë ku votuesi do të votojë në mënyrë që të ruhet fshehtësia e votës së tij. Tavalina e votimit duhet të vendoset në atë mënyrë që votuesi ta ketë shpinën e kthyer nga komisionerët dhe vëzhguesit e pranishëm. KNJZ-të mund të caktojnë më tepër se një tavolinë të votimit, por jo më tepër se tri (3) tavolina për vendvotim.
4. Vëzhguesit e akredituar të kandidatëve dhe OJQ-të e akredituara për vëzhgim kanë të drejtë të paraqesin vërejtjet për mënyrën e përgatitjes fizike të vendvotimit. Vërejtjet e tilla duhet t'i shënojnë në Librin e Votimit.
5. Rregullimi teknik dhe fizik në vendvotim nuk do të ndryshohet deri në përfundimin e procesit të votimit, respektivisht deri në mbylljen e tij.

### **Neni 51** **Hapja dhe mbyllja e vendvotimit**

1. KNJZ-të janë të obliguara që të hapin vendvotimet në orën 09:00 të ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e OMK-së.
2. Shtyrja e hapjes së vendvotimit mund të bëhet vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme që pamundësojnë hapjen në kohë të vendvotimit, siç janë fatkeqësitë natyrore, shkaqet objektive që rrezikojnë jetën dhe integritetin trupor të njeriut dhe shkaqet të tjera që pamundësojnë hapjen e vendvotimit. Menjëherë pas pushimit të rrethanave të tilla komisionerët janë të obliguar që të hapin vendvotimin po që se nuk ka arsye për shtyrjen e mëtutjeshme të hapjes së vendvotimit. Rastet e tilla duhet të shënohen domosdoshmërisht nga kryesuesi i KNJZ-së.
3. Vendvotimet e hapura sipas paragrafit 1 të këtij neni do të mbyllën në orën 15:00 të së njëjtës ditë kur mbahet votimi. Pas mbylljes së vendvotimit askush nuk do të lejohet të votojë. Vendvotimi do të konsiderohet i mbyllur me votimin e votuesit të fundit i cili është i pranishëm pranë vendvotimit në orën 15:00.
4. KNJZ-të mund të mbyllin vendvotimin para kohës së përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni po që se kanë votuar të gjithë anëtarët me të drejtë vote nga Lista e Votuesve.
5. Komisionerët duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së mbajtjes së procesit zgjedhor, ku të paktën duhen të jenë të pranishëm dy nga tre komisionerë të KNJZ-ve, kur për lëshimin e vendvotimit është natyra e nevojave personale. Mungesa e cilitdo nga komisionerët nuk mund të jetë në kohëzgjatje më tepër se tridhjetë (30) minuta.
6. Për.zbatimin e këtij neni do të kujdeset ekskluzivisht kryesuesi i KNJZ-së.

### **Kapitulli XIV - Menaxhimi i procesit të votimit**

### **Neni 52** **Procesi i votimit**



1. Me hapjen e vendvotimit sipas kohës së përcaktuar me rregullimin e brendshëm zgjedhor të OMK-së konsiderohet se ka filluar procesi i votimit.
2. Votuesi me të hyrë në vendvotim është i obliguar që ta dëshmojë identitetin e tij për identifikimin e të drejtës së tij në votë në Listën e Votuesve me dokumentet në vijim:
  - 2.1 Kartelën e institucionit shëndetësor ku është i punësuar në të cilën është i evidentuar numri i licencës;
  - 2.2 Cilindo dokument identifikues të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës siç janë:
    - 2.2.1 Letërnjoftimi;
    - 2.2.2 Patentë shoferi; dhe
    - 2.2.3 Pasaporta.
  - 2.3 Certifikatën e licencës në mbështetje të ndonjë dokumenti që vërteton identitetin e votuesit.
3. Komisioneri i Listës së votuesit pasi që ta ketë vërtetuar identitetin e votuesit dhe ka gjetur emrin e tij në Listën e Votuesit, duhet që të kërkojë nga votuesi që të nënshkruhet në rubrikën e Listës së Votuesve në hapësirën e dedikuar për nënshkrim për votuesin e identifikuar në Listën e Votuesve.
4. Pas nënshkrimit në Listën e Votuesve, komisioneri kontrollor do t'i dorëzojë fletëvotimin e palosur dyfish, duke u përmbajtur nga cilido udhëzim për të favorizuar për votim cilindo nga kandidatët. Komisioneri kontrollor mund të njoftojë votuesin vetëm për rregullsinë e mënyrës së votimit që i përket të drejtës që në fletëvotim votuesi të shënojë vetëm njërin nga kandidatët e listuar në fletëvotim.
5. Votuesi pasi që ta pranojë fletëvotimin do të drejtohet në tavolinën e votimit e cila është vendosur në pajtim me dispozitën e paragrafit 3 të nenit 6 të kësaj rregulle zgjedhore. Pasi që votuesi ta ketë përfunduar votimin, fletëvotimin e tij ai duhet ta fus në kutinë e votimit. Komisioneri kontrollor është i obliguar që të verifikojë futjen e fletëvotimit në mënyrë që në fletëvotimin e palosur të shihet vula zyrtare e KQZ-së.

### **Neni 53**

#### **Rendi dhe rregulli në vendvotim**

1. Kryesuesi i vendvotimit do të kujdeset që në vendvotim të sigurohet rendi dhe rregulli në kuptim të respektimit të procedurave dhe përmbajtjes së pjesëmarrësve në proces zgjedhor nga veprimet e ndaluara me rregullimin e përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Kryesuesi është i obliguar që mos të lejojë hyrjen dhe qëndrimin e personave në vendvotim, përfshirë edhe votuesit pasi ta kenë përfunduar votimin. Votuesit do të futen në vendvotim deri në atë numër sa nuk cenohet rendi në vendvotim.
3. Komisionerët, vëzhguesit dhe cilido nga votuesit e pranishëm nuk lejohet që të ndikojnë në çfarëdo mënyre tek votuesit për të votuar ndonjërin nga kandidatët.
4. Në rast se ndonjëri nga të pranishmit nuk respekton rregullin nga paragrafi 3 i këtij neni, kryesuesi i vendvotimit ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen. Në rast se veprimi i tillë përsëritet nga personi i njëjtë kryesuesi ka të drejtë që të kërkojë largimin e tij nga vendvotimi. Kryesuesi është i obliguar

që në çdo rast kur refuzon personi i tillë që të veprojë sipas kërkesave të tij, të lajmërojë organet e rendit.

5. Kur veprimet nga paragrafi 4 i këtij neni ndërmerren nga ndonjëri nga komisionerët, kryesuesi do të veprojë në të njëjtën mënyrë sikurse në paragrafin e cituar. Në rast të largimit nga vendvotimi i komisionerit, procesi i votimit do të vazhdojë. Prosesi i votimit do të ndalohet në rast se në vendvotim nga tre (3) komisionerë mbetet vetëm kryesuesi, atëherë ai do të kontaktojë me Sekretariatit e KQZ-së dhe me vendim të KQZ-së do të autorizohet një person që të përmbush kushtin minimal të pranisë prej së paku dy komisionerëve, përfshirë kryesuesin e vendvotimit.
6. Në çdo rast kur vije deri te cenimi i rendit dhe rregullit në vendvotim, vërejtjet e tilla dhe veprimet sipas këtij neni do të shënohen në Librin e Votimit.

#### **Neni 54** **Libri i Votimit**

1. Libri i Votimit është formë e përcaktuar nga KQZ-ja në të cilin shënohen vërejtjet dhe ngjarjet e rëndësishme që ndërlidhen me procesin zgjedhor në vendvotimin përkatës gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Libri i Votimit mirëmbahet dhe ruhet ekskluzivisht nga kryesuesi i vendvotimit.
3. Në Librin e Votimit të drejtën për të shënuar vërejtjet kanë komisionerët dhe vëzhguesit e akredituar. Në çdo rast kur votuesi paraqet vërejtjet lidhur me procesin e votimit, kryesuesi është i obliguar që ta shënojë deklaratën e tij dhe pasi që t'ia lexojë deklaratën e shënuar e nënshkruan së bashku me votuesin i cili ka paraqitur vërejtjen.
4. Libri i Votimit është material zgjedhor dhe si i tillë duhet të dorëzohet në KQZ së bashku me materialin tjetër përcjellës zgjedhor.

#### **Neni 55** **Votimi me kusht**

1. Në rast se votuesi nuk mund të gjejë emrin dhe mbiemrin e tij në Listën e Votuesve, ndërkaq me dokumentin identifikues dëshmon se posedon licencën për ushtrimin e veprimtarisë mjekësore dhe në kuptim të rregullimit të brendshëm të OMK-së plotëson kushtet për realizimin e të drejtës së votës, atij i lejohet votimit me kusht.
2. Në rastet sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi i tillë duhet të dëshmojë posedimin e licencës dhe dëshminë e ushtrimit të veprimtarisë në institucionin gjegjës të Njësisë Zgjedhore.
3. Pasi që vërtetohet fakti juridik i paraparë me këtë nen, votuesit me kusht do t'i merren të dhënat personale duke përfshirë edhe numrin e licencës të cilat shënohen në rubrikë të veçantë në Listën e Votuesve të dedikuar për votim me kusht, me ç' rast do të nënshkruhet në rubrikën e dedikuar për nënshkrim të votuesit me kusht.



4. Pasi që komisioneri kontrollor ia jep për votim fletëvotimin dhe votuesi të ketë votuar, fletëvotimi i palosur do të futet në zarf i cili do të ruhet nga kryesuesi i vendvotimit. Votat me kusht dorëzohen në KQZ duke mos i përfshirë në votat e numëruara në kuti.
5. Numërimi i votave me kusht ekskluzivisht bëhet nga KQZ-ja.

## **Kapitulli XV - Procesi i numërimit të votave**

### **Neni 56 Numërimi i votave**

1. Pas mbylljes së vendvotimit, kryesuesi i vendvotimit do t'i tërheqë vërejtjen vëzhguesve që mos ta lëshojnë vendvotimin deri në përfundimin e procesit të numërimit të votave. Në rast se ndonjëri nga ta e lëshon vendvotimin, kryesuesi i njofton se nuk do të lejojë hyrjen e sërishme të tyre në vendvotim.
2. Procesi i numërimit fillon me numërimin e votuesve të nënshkruar në Listën e Votuesve dhe numrin e tillë e evidentojnë për shënim në procesverbal.
3. Më pas numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe po ashtu ky numër evidentohet dhe shënohet në procesverbal.
4. Me hapjen e kutisë së votimit fillon diferencimi i fletëvotimeve të dëmtuara duke shënuar numrin e tyre.
5. Pas diferencimit të fletëvotimeve të dëmtuara, procesi i numërimit fillon me identifikimin e fletëvotimeve të pavlefshme që konsiderohen kur:
  - 5.1 në fletëvotim janë shënuar më tepër se një kandidat;
  - 5.2 kur nuk është i qartë votimi i votuesit;
  - 5.3 kur në fletëvotim janë shënuar përmbajtjet në përjashtim të shënimit të kandidatit i cili është shënuar;
  - 5.4 fletëvotim i pavlefshëm nuk do të konsiderohet nëse është i qartë shënjimi i kandidatit, ndërkaq në fletëvotim është shënuar ndonjë vijë apo shenjë jashtë katrorëve që janë dedikuar për shënjim.
6. Pas diferencimit të votave të pavlefshme, fillon numërimi një nga një votë duke mbajtur evidencën për secilën votë të numëruar.
7. Numërimi do të bëhet në atë mënyrë ku njëri nga komisionerët do të caktohet nga kryesuesi për tregimin e secilit fletëvotim duke e ngritur atë në pozitë të dukshme për të gjithë të pranishmit. Kryesuesi dhe komisioneri tjetër do të mbajnë paralelisht evidencat që në fund të bëhet krahasimi i saktësisë së numërimit.
8. Pas përfundimit të numërimit dhe krahasimit të të dhënave të mbajtura nga kryesuesi dhe njëri nga komisionerët, rezultati i tillë shënohet në procesverbalin e vendvotimit dhe atë të KNJZ-së.



9. Nëse evidenca e mbajtur nga kryesuesi dhe njëri komisioner nuk përputhet, atëherë do të përsëritet numërimi deri në konstatimin e plotë të dyanshëm nga kryesuesi dhe komisioneri.

#### **Neni 57**

#### **Përmbyllja e procesit të numërimit**

1. Pas numërimit të votave dhe përmbylljes së procesverbalit i cili nënshkruhet nga kryesuesi dhe komisionerët e KNJZ-së, fletëvotimet e vlefshme futen në thesin e veçantë dhe diferencohen nga fletëvotimet e dëmtuara dhe ato të pavlefshme. Fletëvotimet e dëmtuara dhe të pavlefshme futen në një thasë të veçantë.
2. Fletëvotimet me kusht që janë të futura në zarfe po ashtu futen në një thasë të veçantë.
3. Materiali nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni futet së bashku në kutinë e votimit së bashku me procesverbalet përcjellëse. Kutia e votimit e mbyllur dorëzohet në Sekretariatit të KQZ-së nga ana e kryesuesit sapo të ketë përfunduar procesi i numërimit dhe ambalazhimit të materialit zgjedhor për dorëzim.
4. KQZ-ja pas pranimit të materialit zgjedhor nga Sekretariati i KQZ-së, do të fillojë procesin e verifikimit dhe përmbledhjes së rezultateve nga KNJZ-të.
5. Materiali zgjedhor duhet t'i dorëzohet Sekretariatit të KQZ-së jo më vonë se ora 20:00 e ditës së zgjedhjeve.

#### **Kapitulli XVI - Mjeti juridik për parregullsitë në vendvotim**

#### **Neni 58**

#### **Procedura e shqyrtimit të ankesave në proces zgjedhor**

1. Secili kandidat që ka marrë pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë të parashtrojë ankesë lidhur me parregullsinë e procesit zgjedhor.
2. Parashtruesi i ankesës mund të parashtrojë ankesën e tij në afat prej 24 orëve nga mbyllja e vendvotimit duke e parashtruar atë pranë KQZ-së.
3. KQZ-ja në afat prej 24 orëve nga skadimi i afatit për ankesë do të vendosë për ankesat e parashtruara me vendim përmes të cilit:
  - 3.1 Aprovon ankesën si të bazuar dhe urdhëron rinumërimin e vendvotimit;
  - 3.2 Aprovon ankesën dhe urdhëron ri-votimin në vendvotimin e caktuar; dhe
  - 3.3 Hedhë poshtë ankesën si të pabazuar apo të palejuar.
4. Vendimi nga paragrafi 3 i këtij neni nuk mund të apelohet, dhe si i tillë mund të kontestohet nga pala me interes juridik përmes padisë së parashtruar në konfliktin administrativ pranë gjykatës kompetente.

5. Vendimi lidhur me ankesat të parashtruara lidhur me procesin zgjedhor nxirret në formë të shkruar dhe të arsyetuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
6. Për ankesat e parashtruara lidhur me procesin zgjedhor, KQZ-ja vendos në një panel prej tre (3) anëtarëve. Paneli për ankesa ka kryesuesin e tij që zgjidhet në mesin e anëtarëve të panelit.
7. Paneli për ankesa vendos me shumicën e votave të anëtarëve të panelit. Mënyra e votimit për çështjen e shqyrtuar nga paneli nuk përfshihet në vendim.

## **Kapitulli XVII - Certifikimi dhe shpallja e rezultatit zgjedhore**

### **Neni 59**

#### **Konstatimi dhe shpallja e rezultatit**

1. Pasi të jenë mbledhur të dhënat nga procesverbalet e KNJZ-ve, KQZ-ja konfirmon kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në kuadër të Njesisë Zgjedhore. Kandidatët që kanë marrë më së shumti vota sipas bazës së konstatuar deleguese nga KQZ-ja konsiderohet se kanë fituar mandatin zgjedhor.
2. Në rast se dy apo më shumë kandidat kanë vota të barabarta për fitimin e mandatit, në prani të KQZ-së hedhet shorti sipas të cilit konstatohet fituesi i mandatit.
3. KQZ-ja pasi ta ketë përfunduar procesin e evidentimit të mandateve krijon listën unike të kandidatëve që kanë fituar mandatin. Kjo listë materializohet nga Sekretariati i KQZ-së dhe procedohet për certifikim në mbledhjen e thirrur nga Kryesuesi i KQZ-së.
4. KQZ-ja e certifikon rezultatit zgjedhor jo më larg se pesë (5) ditë nga dita e zgjedhjeve, por jo më herët se 48 orë pas mbylljes së vendvotimeve. Certifikimi i rezultatit zgjedhor miratohet me aprovimin e 2/3 së anëtarëve të KQZ-së.
5. Në afat prej 24 orëve para certifikimit të rezultatit zgjedhor, KQZ-ja publikon rezultatit preliminar në ueb faqen zyrtare të OMK-së.
6. Palët e pakënaqura me rezultatit e publikuar mund të paraqesin ankesën e tyre pranë KQZ-së në afat prej 24 orëve nga ora e publikimit të rezultatit preliminar. KQZ-ja do të shqyrtojë ankesën e tillë në afat prej 24 orëve nga ora e pranimit të ankesës. Parashtrimi i ankesës e pezullon procesin e certifikimit të rezultatit deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të KQZ-së.
7. Ndaj vendimit të KQZ-së lidhur me shqyrtimin e ankesave ndaj rezultatit preliminar, palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurën e konfliktit administrativ pranë Gjykatës kompetente për konteste administrative.

### **Neni 60**

#### **Përfundimi i procesit zgjedhor**

Në kuptim të kësaj rregulle zgjedhore procesi zgjedhor për Kuvendin e OMK-së konsiderohet i përfunduar me shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja.

### **Neni 61**

#### **Zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit të OMK-së**

1. Në rast se për cilëndo rrethanë të paraparë me dispozitat e Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, anëtarit të Kuvendit i ka pushuar mandati para kohës së skadimit të mandatit të Kuvendit të OMK-së, zëvendësimi i të njëjtit do të bëhet nga KQZ-ja.
2. Zëvendësimi do të bëhet me njoftimin formal nga Kryetari i OMK-së si kryesues i Kuvendit të OMK-së.
3. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e njoftimit formal nga Kryetari i OMK-së, KQZ-ja do të bëjë zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të cilit i ka pushuar para kohe mandati, duke e konstatuar zëvendësimin e tillë me kandidatin e të njëjtës njësi zgjedhore me numër të votave që është renditur pas anëtarit të cilit i ka pushuar mandati.
4. Në rastet kur në njësinë zgjedhore nuk ka kandidat i cili e pason me vota anëtarin e Kuvendit i cili duhet të zëvendësohet, KQZ-ja i shpallë zgjedhjet në atë njësi zgjedhore, duke i përgjysmuar afatet e parapara me këtë rregullore sa i përket procedurave zgjedhore të parapara me këtë Kod.
5. Të gjitha dispozitat e këtij Kodi janë të zbatueshme përshtatshëmrisht me rastin e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit lidhur me organizimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë në njësitë përkatëse zgjedhore.

## **KREU VIII - PROCEDURAT E VEÇANTA TË ZGJEDHJES SË ORGANEVE TË OMK-SË**

### **Kapitulli XIX - Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendës Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës**

#### **Neni 62**

1. KQZ shpallë zgjedhjet për Kryetar të OMK, më së voni 5 (pesë) ditë pas ditës së certifikimit të rezultatit zgjedhor.
2. Dorëzimi i formularëve për kandidim së bashku me CV dhe programin, dorëzohen në KQZ, 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së zgjedhjeve për Kryetar.
3. Secila kandidaturë për Kryetar të OMK duhet të mbështetet me nënshkrimet e 20 anëtarëve të Kuvendit të OMK.
4. Çdo anëtarë i Kuvendit ka të drejtë të japë nënshkrimin vetëm për një kandidaturë.



5. Secili kandidatë për Kryetar duhet të paraqes programin të njëjtën ditë.

### **Neni 63**

1. Kuorumi për zgjedhjen e Kryetarit të OMK është 2/3 e delegatëve të Kuvendit të OMK.
2. Konsiderohet se është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OMK-së.
3. Në rast se asnjëri kandidatë nuk ka fituar shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, dy kandidatë me numrin më të madh të votave do të kualifikohen për rundin e dytë të votimit.
4. Në rundin e dytë të votimit konsiderohet se është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit që kanë votuar.
5. Me përfundimin e procesit zgjedhor, KQZ shpallë rezultatin e zgjedhjes së Kryetarit të Odës dhe me këtë rast përpilon procesverbalin e veçantë në të cilin evidentohen hollësitë e procesit zgjedhor. Formën e procesverbalit të tillë e miraton KQZ-ja.

### **Neni 64**

#### **Zgjedhja e Zv. kryetarëve të OMK-së**

Me propozim të Kryetarit, Kuvendi i OMK me shumicë votash miraton propozimin e Kryetarit për zgjedhjen e Zv. Kryetarëve të OMK-së në një votim të hapur.

### **Neni 65**

#### **Zgjedhja e Anëtarëve të Këshillit Drejtues**

1. Në afat prej 30 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit të OMK duhet të bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Odës.
2. Kryetari dhe Zv. Kryetarët e OMK janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Kandidaturat për anëtarë të Këshillit Drejtues të Odës duhet të propozohen në seancën e Kuvendit të OMK.
4. Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues është i fshehtë.
5. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

### **Neni 66**

#### **Zgjedhja e Këshillit Mbikëqyrës të Odës**

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OMK bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Odës.
2. Këshilli Mbikëqyrës i Odës ka Kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Odës me votim të drejtpërdrejt dhe të fshehtë.
3. Kandidaturat për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Odës propozohen në seancën e Kuvendit të OMK.
4. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

#### **Neni 67 Zgjedhja e Këshillit Etik**

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OMK bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik të Odës.
2. Këshilli Etik i Odës ka Kryetarin dhe 4 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Odës me votim të drejtpërdrejt dhe të fshehtë.
3. Kandidaturat për anëtarë të Këshillit Etik të Odës propozohen në seancën e Kuvendit të OMK.
4. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

#### **Neni 68 Zgjedhja e Gjyqit të Nderit**

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OMK bëhet zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit të Odës.
2. Gjyqi i Nderit i Odës së Mjekëve ka 5 anëtarë, Kryetarin, Zv. Kryetarin dhe 3 anëtarë.
3. Një (1) anëtarë i Gjyqit të Nderit propozohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Kandidimi për Kryetarë të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga së paku 10 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës, ndërsa për Zv. Kryetarin dhe dy anëtarët e tjerë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OMK.
5. Votimi është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.
6. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

#### **Neni 69 Zgjedhja e Prokurorit të Odës**

1. Së paku 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OMK bëhet zgjedhja e anëtarëve të Prokurorit të Odës.
2. Prokurori dhe Zv. Prokurori zgjidhen nga Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për Prokurorë të Odës duhet të mbështet nga së paku 10 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës, ndërsa për Zv. Prokurorë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OMK.
4. Votimi është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.
5. Konsiderohen se janë të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më shumë vota.

### **Neni 70**

#### **Komisionet e Përhershme të Odës**

1. Komisionet e Përhershme të Odës janë:
  - 1.1. Komisioni për çështje etike;
  - 1.2. Komisioni për licencim;
  - 1.3. Komisioni për edukim specialistik;
  - 1.4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
  - 1.5. Komisioni për buxhet dhe financa;
  - 1.6. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

### **Neni 71**

#### **Zgjedhja e Komisioneve të Përhershme të Odës**

1. Komisionet nga neni paraprak kanë nga shtatë (7) anëtarë nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryesuesi dhe Zv. Kryesuesi i Komisionit.
2. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Odës propozohen nga Këshilli Drejtues dhe propozimi i tillë aprovohet në seancë të Kuvendit të OMK-së me votim të hapur të propozimit të Këshillit Drejtues për secilin komision veç e veç.
3. Propozimet nga paragrafi 2 i këtij neni konsiderohet se janë miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit që kanë përmbushur kuorumin e përgjithshëm.

### **Neni 72**

Fushëveprimi i Komisioneve të përhershme përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuar nga Kuvendi i Odës.

### **Neni 73**

#### **Zgjedhja e Komisioneve të përkohshme (add hoc) dhe të veçanta**



1. Me propozimin e Këshillit Drejtues, Kuvendi i Odës mund të themelojë Komisione të Përkohshme dhe të Veçanta.
2. Komisionet e Përkohshme zgjidhen në kohë të caktuar dhe për çështje specifike për të cilat konsiderohet se nevojitet trajtim i ndarë dhe jashtë fushëveprimit të komisioneve të përhershme.
3. Komisionet e Veçanta zgjidhen me qëllim të përmbushjes së nevojave specifike administrative të Odës. Komisionet e tilla veprojnë sipas mandatit të përkufizuar nga Kuvendi i Odës me akt të veçantë.
4. Fushëveprimi i Komisioneve të Përkohshme dhe të Veçanta përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuar nga Kuvendi i Odës.
5. Miratimi i propozimit për themelimin të Komisioneve të Përhershme dhe të Veçanta bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse ai i Komisioneve të Përhershme.

#### **Neni 74**

#### **Mbikëqyrja dhe menaxhimi i procesit të zgjedhjeve të veçanta të organeve të OMK-së**

1. Mbikëqyrja e procesit të zgjedhjeve të organeve që janë të përfshira në këtë kapitull, në përjashtim të zgjedhjes së komisioneve të Odës që bëhet në procedurë të rregullt vendimmarrëse të Kuvendit të Odës, e bën KQZ-ja.
2. I gjithë materiali zgjedhor, përfshirë procesverbalet dhe dokumentet e tjera të evidencës së procesit zgjedhor përgatiten dhe miratohen nga KQZ-ja.
3. Të gjitha dispozitat të tjera në këtë Kod zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe për procesin zgjedhor të zgjedhjes së organeve sipas këtij kapitulli.

### **KREU IX - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 75**


Këtij Kodi do t'i bashkëngjiten materialet procedurale që shërbejnë për drejtimin e procesit zgjedhor.

#### **Neni 76 Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**Prishtinë, 27 dhjetor**

**Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci**



Page 33 nga 34

